



Datë: 22.05.2025
Numër Protokolli: 3405/2025

A.nr.554/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi Bajraktari dhe Eshref Shabani-anëtarë, me Avdyl Bekteshi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurën sipas ankesës me numër A.nr.554/2025, të datës 26.03.2025, të parashtruar nga ankuesi I.D,kundër Komunës së Ferizajit, në çështjen juridike “*kontestim konkursi*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180, si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 22.05.2025, mori këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet si e bazuar** ankesa A.nr.554/2025, e datës 26.03.2025, e parashtruar nga ankuesi I.D.
- II. Shfuqizohet** Njoftimi i datës 19.03.2025, i Njesisë së Burimeve Njerëzore për shpalljen e kandidatëve fitues, ndërsa **Anulohet** në tërësi procedura e rekrutimit RN00016592 për Grupi i Teknologjisë Informative, pozita “*Zyrtar i Lartë për Teknologji Informative*”, e shpallur nga Komuna e Ferizajit.
- III. Obligohet** Kryetari i Komunës së Ferizajit, që të ndërmerret të gjithë veprimet e nevojshme me qëllim të zbatimit të këtij vendimi si në pikën **II** të dispozitivit, në afatin prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga dita e pranimit të këtij vendimi.
- IV.** Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendi.

A r s y e t i m

Kandidati për pranim në shërbimin civil, I.D (në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesi), me datë 26.03.2025, ka parashtruar ankesë për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës e cila është regjistruar nën shenjë A.nr.554/2025, kundër procedurës së rekrutimit me shifër RN00016592 për pozitën Zyrtar i Lartë për Teknologji Informative, i shpallur nga Komuna e Ferizajit.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datën 01.04.2025 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Komuna e Ferizajit, ndërsa kjo e fundit, me datë 07.04.2025, ka dorëzuar përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e lëndës.

Kryetari i Këshillit me datë 06.05.2025 ka nxjerrë Vendimin me shifër VK/2025 dhe numër protokoli:3045/2025, përmes të cilit ankesës së ankuesit nën shenjë A.nr.554/2025 të datës 26.03.2025 ia ka vazhduara fatin e vendimmarrjes edhe për dhjetë (10) ditë të tjera, ditë pune.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit) për vendosje meritore administroi këto prova: Ankesën me numër protokoli 2016/2025 e parashtruar nga ankuesi më datën 26.03.2025 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin e Këshillit VK/2025 të datës 06.05.2025; Njoftimin e datës 28.02.2025; Njoftimin e datës 19.03.2025; Njoftimin e datës 14.03.2025; Konkursin e datës 03.02.2025; Kopjen e pasaportës së ankuesit; Formularin e parashtrimit të ankesës; Kërkesë për përgjigje në ankesë e datës 01.04.2025; Përgjigje në kërkesë e datës 07.04.2025; vendimin për themelimin e komisionit i datës 14.02.2025 me akt emërimet e anëtarëve të komisionit; Listën e aplikantëve; Aplikacioni e ankuesit të datës 04.02.2025 më dokumentacionin e bashkangjitur; Diplomën e datës 08.04.2013; pasqyrë e llogarisë së trustit; Aplikacionin e kandidates së suksesshëm të datës 20.02.2025 me dokumentacionin e bashkangjitur; Diplomën e datës 17.07.2024; Kontratë pune e datës 01.04.2024; Vërtetim pune i datës 01.01.2023; Vërtetim punësimi i lëshuar nga MITC; Pasqyrë e llogarisë së Trustit; Kopje e letërnjoftimit të kandidates së suksesshëm; Formulari i renditjes përfundimtare i datës 19.03.2025; Formularët e Vlerësimit të përgjithshëm të Esës të datës 14.03.2025 për kandidatët; Testim nga Eseja.

Kolegji i Këshillit nga administrimi i shkresave të lindës të ofruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankesa e ankuesit, është e **bazuar**, sepse:

Nga administrimi i shkresave të lëndës, Kolegji i Këshillit konstatoi se Komuna e Ferizajit, më datë 03.02.2025 ka shpallur konkursin me numër reference RN00016592, për Grupi i Teknologjisë Informative, pozita “Zyrtar i Lartë për Teknologji Informative- Profesional 1”, në kuadër të Zyrës së Kryetarit, ku afati për aplikim ka qenë nga data 04.02.2025 deri më 05.03.2025, ndërsa sipas

shkresave të lëndës, fazën e verifikimit paraprak e kanë kaluar 7 kandidatë, në mesin e tyre edhe ankuesi.

Tutje, ankuesi i është nënshtruar testimit me shkrim, ndërsa nga Njësia e Burimeve Njerëzore, është njoftuar se ka arritur të grumbulloi gjithsejtë 48.2 pikë, të cilat nuk ka qenë të mjaftueshme për të kaluar testin me shkrim nga 50 pikë sa është e nevojshme për të vazhduar në procedurën e rekrutimit, respektivisht intervistën me gojë, sikurse përcaktohet me dispozitat e aplikuara nga Rregullorja Nr. 15/2023 Për Procedurën e Pranimi në Shërbimin Civil, neni 10 paragrafi 2 ku përcaktohet se: *‘2. Vetëm kandidatët që kanë marrë të paktën pesëdhjetë (50) pikë në testimin me shkrim, kanë të drejtë të marrin pjesë në intervistë.’*, ndërsa sipas Formularët të datës 19.03.2025 për vlerësimin përfundimtar të kandidatëve, pas kryerjes së intervistimit me gojë, rezultojnë se kandidatja që ka marrë pikë të mjaftueshme është N.A me gjithsejtë 92.8 pikë, prej të cilave 64.4 pikë nga testi me shkrim, kurse 28.4 nga intervista me gojë, e cila rezultojnë të jetë edhe kandidatja e suksesshme në procedurën përkatëse të rekrutimit.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshill, kundër Njoftimit të datës 19.03.2025 të Njesisë së Burimeve Njerëzore të Komunës së Ferizajt lidhur me shpalljen e kandidatit fitues, pretendon se të njëjti i është bërë e pa drejtë, respektivisht pretendon se vlerësimi i testimit nuk ka qenë objektiv nga ana e Komisionit të Pranimi, ashtu që dyshon në objektivitetin e vlerësimit të testit me shkrim për kandidatin e suksesshëm.

Fillimisht Kolegji i Këshillit, nga analizimi i testit me shkrim për Esen e ankuesit, konstatoi se i njëjti nga testi me shkrim kishte arritur të grumbulloi gjithsejtë 48.2 pikë (prej të cilave 40 pike nga pyetjet me përgjigje opsionale, kurse 8.2 pikë nga eseja), ndërsa kandidatja e suksesshme nga testi me shkrim kishte arritur të grumbulloi gjithsejtë 64.4 pikë (prej të cilave 50 pike nga pyetjet me përgjigje opsionale, kurse 16.4 pikë nga eseja).

Kolegji i Këshillit, në kuptim të shqyrtimit të pretendimeve ankimore dhe duke u bazuar në kuadrin ligjor në fuqi, me qëllim të konstatimit nëse procedura e rekrutimit është zhvilluar në pajtueshmëri me dispozitat e ligjit material, ka analizuar ligjshmërinë e procedurës së pranimi me RN00016592, për Grupi i Teknologjisë Informative, pozita *“Zyrtar i lartë për Teknologji Informative”* ka konstatuar se për këtë pozitë të punës si kërkesa të përgjithshme formale janë përcaktuar: ***“Arsimimi i kërkuar: Diplomë e arsimit të lartë e nivelit të parë (Bachelor) – Shkenca kompjuterike, Inxhinieri kompjuterike dhe softuerike, Informatikë inxhinierike, Teknologji e informacionit dhe Telekomunikim, Informatikë dhe Teknologji informative, Inxhinieri Elektroteknike Kompjuterike me Telekomunikacion:***

Përvoja e punës e kërkuar: Së paku dy (2) vite përvojë pune profesionale në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës.”

Para se të lëshohet në shqyrtimin e pretendimeve ankimore të ankuesit, Kolegji i Këshillit analizoi dosjen e kandidates së suksesshëm të bashkangjitur përmes aplikacionit me rastin e aplikimit në konkurs me datë 20.02.2025, dhe konstatoi se e njëjta posedon Diplomën e datës 17.07.2024 me numër:1184/24 përmes së cilës dëshmohet se e njëjta ka mbaruar studimet themelore me datë 06.07.2024 në Kolegjin AAB-Programi Menaxhment dhe Informatikë, andaj Kolegji i Këshillit duke marr për bazë faktin se përvoja e punës profesionale llogaritet vetëm përvoja e punës e fituar pas diplomimit, rrjedh se ankuesja pas datës së diplomimit nuk mund t'i ketë dy (2) vite përvojë pune profesionale, respektivisht e njëjta sipas Vërtetimit të lëshuar nga Menagement and Information Technology Consulting M&IT, konstatohet fakti se kandidatja në fjalë ka qenë e punësuar në këtë kompani nga data 01.06.2023 e deri me datë 30.12.2024, respektivisht e njëjta pas datës së diplomimit 06.07.2024 ka vetëm pesë (5) muaj e njëzet e pesë (25) ditë përvojë pune profesional në fushën për të cilën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës.

Prandaj, thënë si më lartë Kolegji i Këshillit duke marrë për bazë dispozitat e aplikuara nga neni 7 paragrafi 1 i Rregullores Nr.15/2023 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil ku përcaktohet se: *“1. Verifikimi paraprak është procesi i verifikimit nëse kandidatët për pranim në shërbimin civil plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe ato të veçanta, sipas shpalljes së konkursit.”*, konstatoi se procedura e pranimit RN00016592 për Grupi i Teknologjisë Informative, pozita *“Zyrtar i Lartë për Teknologji Informative”*, është zhvilluar në kundërshtim me dispozitat e aplikuara nga nenin 7 paragrafi 1, ndërlidhur me nenin 9 paragrafi 1, nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, pasi që kandidatja e suksesshme nuk ka plotësuar kriteret e konkursit, respektivisht kriterin e përvojës së punës profesionale prej dy (2) vitesh, sikurse ishte përcaktuar në konkursin e datës 03.02.2025.

Kolegji i Këshillit, meqenëse konstatoi të gjeturat e theksuara si më lartë, nuk u lëshuar në shqyrtimin e pretendimeve ankimore të ankuesit lidhur me vlerësimin e testit me shkrim, pasi që një fakt i tillë nuk do ta ndryshonte natyrën vendimmarrëse të kësaj çështje administrative, pasi që janë konstatuar shkelje esenciale të parimeve të pranimit në shërbimin civil, andaj ankesa e ankuesit u aprovua vetëm mbi bazën e konstatimeve të dhëna si në këtë vendim, ndërsa Kolegji i Këshillit vendosi të shfuqizoi Njoftimin e datës 19.03.2025 të Njesisë së Burimeve Njerëzore të Komunës së Ferizajit për shpalljen e kandidates së suksesshme dhe të anuloi në tërësi procedurën e rekrutimit RN00016592 për Grupi i Teknologjisë Informative, pozita *“Zyrtar i Lartë për Teknologji Informative”*, sikurse në dispozitivin e këtij vendimi.

Andaj, duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1, nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180, si dhe nenit 132 paragrafi 1.4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij Vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda, A.nr.554/2025, datë 22/05/2025.

Avdyl BEKTESHI

Procesmbajtës

Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit I.D;
- Komunës së Ferizajit (Kryetarit të Komunës, dhe Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore), si dhe;
- Arkivit të KPMSHCK-së.